



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

K.DH.SH.II.nr.440/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.N.P “EUROING”. me seli në Suharekë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Teuta Beka avokate nga Prishtina, kundër debitorit Ndërmarrja Publike Banesore, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.885/23 i datës 23.10.2023, me datën 09.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e debitorit Ndërmarrja Publike Banesore, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.885/23 i datës 23.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.885/23, të datës 23.10.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Ndërmarrja Publike Banesore, me seli në Prishtinë, dhe ka Lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.210/2023 të datës 26.05.2023, të lëshuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit dhe të kthehet në rishqyrtim lënda pranë Dhomave të shkallës së parë të Gjykatës Komerciale.

Kreditori përmes përfaqësueses së autorizuar, në përgjigje në ankesë ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se nuk ekziston asnjë bazë ligjore mbi të cilën mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, me propozim që të refuzohet ankesa e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.N.P “EUROING”, me seli në Suharekë, ka caktuar zbatimin e përmbarimit sipas urdhrin P.nr.210/2023 të datës 26.05.2023 ndaj debitorit Ndërmarrja Publike Banesore me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.670/19 të datës 29.12.2020, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Shk.II.nr.888/22 të datës 13.04.2023, duke e detyruar debitorin që kreditorit t’i paguajë shumën e përgjithshme prej 484,661.00 Euro, me kamatë sipas normës prej 3.5%, e cila në vendin e përmbushjes paguhet për mjetet e deponuara, pa destinim të caktuar në afat prej më tepër se një vit nga data e ushtrimit të padisë më 07.06.2011 e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore për përpilim të propozimit në shumë prej 312.00 Euro, si dhe shpenzimet tjera, ndërsa përmbushja të realizohet përmes konfiskimit të llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e mjeteve financiare nga kontoja ose kontot bankare të debitorit në të gjitha bankat në Kosovë. Nëse nuk ka mjete në llogari apo është i pamundshëm përmbarimi në llogari bankare, atëherë përmbaruesi të sekuestrojë, vlerësojë dhe të shesë sendet e luajtshme apo pronat e paluajtshme që

gjenden në pronësi apo posedim të debitorit dhe me shitjen e tyre të përmbushet borxhi dhe shpenzimet tjera të kreditorit.

Kundër urdhrit përbarimor, debitori ka paraqitur prapësim, në të cilin ka theksuar se urdhri përbarimor është në kundërshtim me dispozitat e procedurës përbarimore, pasi që është përcjellur me shkelje ligjore të shumta. Ndër të tjera, ka shtuar se afati për përmbushje vullnetare të detyrimit ende nuk ka kaluar, ndërsa sa i përket aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, ndaj të njëjtit kemi ushtruar revizion të Gjykatës Supreme dhe në këtë drejtim përbarimi nuk mund të ekzekutohet deri në nxirjen e një vendimi nga kjo gjykatë, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përbarimor i Përbaruesit Privat P.nr.210/2023 i datës 26.05.2023.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, ka deklaruar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe të paargumentuara me asnjë provë materiale. Ka shtuar se propozimi për urdhër përbarimor i plotëson kushtet e parapara për të qenë titull përbarimor konform dispozitave ligjore të LPP-së, pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike nr.EK.nr.670/19 i datës 29.12.2020, është bërë i plotfuqishëm me datë 13.04.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 18.05.2023, duke theksuar se debitori nuk e ka përmbushur obligimin e caktuar në afatin paritiv-vullnetar ndaj kreditorit jashtë procedurës përbarimore. Për këto arsye i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, si dhe të lejohet urdhri përbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.885/23, i datës 23.10.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Ndërmarrja Publike Banesore, me seli në Prishtinë, dhe ka lënë në fuqi Urdhrin Përbarimor P.nr.210/2023 të datës 26.05.2023, të lëshuar nga Përbaruesi Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dokumentet përbarimore – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.670/19 të datës 29.12.2020, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Shk.II.nr.888/22 të datës 13.04.2023, janë të përbarueshme ashtu siç përcaktohet në nenin 24 par.1 të LPP-së. Më tej ka theksuar se

dokumentet përmbarese i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarese i dorëzohet edhe dokumenti përmbarese, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbareshmërisë për përmbareshmëri”*.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është marrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se në rastin konkret dokumenti përmbarese në bazë të cilit është lejuar përmbarimi është – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.670/19 të datës 29.12.2020, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Shk.II.nr.888/22 të datës 13.04.2023, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, i cili përcakton se: *“dokument përmbarimor është vendimi përmbarese i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbarese”* dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbarimor është i përshatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Kjo gjykatë vlerëson se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.670/19 të datës 29.12.2020, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Shk.II.nr.888/22 të datës 13.04.2023, i cili është bërë i formës së prerë me datën 13.04.2023 dhe i ekzekutueshëm me datën 18.05.2023, në bazë të dispozitave të nenit 21 dhe 22 të LPP-së është dokument përmbarues dhe në këtë rast përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 dhe 27 i LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Prandaj, Gjykata Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, sepse nuk ekziston asnjë nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit të cilat janë të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit se ndaj Aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Shk.II.nr.888/22 të datës 13.04.2023, i njëjti ka ushtruar revizion në Gjykatën Supreme dhe se në këtë drejtim përmbarimi nuk mund të ekzekutohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata Supreme, mirëpo e gjeti si të pa bazuar, ngase edhe kjo gjykatë vlerëson se paraqitja e revizionit nuk paraqet pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë, pasi në bazë të nenit 213 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore përcaktohet se *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.440/24 me datën 09.01.2025

Gjyqtari,  
Krenar Berisha